

---

# **REALIZIMI I BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË**

---

Viti 2020

---

## HÝRJE

Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020 është mbështetur në ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligji nr. 68 date 27.04.2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”; Udhëzimit nr.22 dt 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 157 datë 26.12.2019 ‘Për miratimin e PBA 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020, (i ndryshuar), ju prezantojmë raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2020, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, me VKB nr.22 datë 17.03.2020 të ardhurat e papërdorura të vitit buxhetor 2019 trashëgohen në buxhetin e vitit 2020.

Pamundësia për të zhvilluar një proces normal për shkak të pandemisë Covid-19, në kushtet kur shumica e administratës publike si në njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato vendore janë duke punuar me staf të reduktuar, si dhe kompanite prodhim/sherbin kane zvogeluar kapacitetet e tyre në kuadër të masave parandaluese të ndërmarra për mospërhapjen e virusit COVID-19 ka bërë që realizimi për vitin 2020 të mos jetë ai i dëshiruar. Realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë është kryer konform udhezimit nr. 14 datë 24.03.2020 “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit te buxhetit ne kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, konkretisht sipas pikës 6, duke realizuar shpenzimet sipas rradhës së prioriteteve dhe duke mos punuar me kapacitet të plotë për shkak të situatës.

# KAPITULLI I

## REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020

### Të Ardhurat nga Taksat dhe Tarifat Vendore.

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Tiranës është mbështetur mbi llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, në aktet ligjore të sistemit fiskal dhe në ecurinë e realizimit në vitet e mëparshme. Ky parashikim ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2020 si pasojë e përjashtimit nga pagesa për sektorë të caktuar të biznesit të cilët u ndikuan negativisht nga situata e krijuar nga pandemia e Covid-19.

Për vitin 2020, plani i të ardhurave është miratuar në shumën 14,864,692,000 lekë.

Në mbyllje të vitit 2020 rezulton se të ardhurat janë realizuar në shumën 14,534,420,053 lekë ose në masën 97.8% ndaj planit, nga të cilat:

- të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 10,391,506,064 lekë
- të ardhurat jottatimore janë realizuar me një vlerë prej 4,142,913,989 lekë.

Kategoria	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë
Të ardhura tatimore	10,453,286,000	10,391,506,064	99%
Të ardhura jo tatimore	4,411,406,000	4,142,913,989	94%
Totali	14,864,692,000	14,534,420,053	97.8%

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore më kryesore të Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet një analize edhe për faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate për vitin 2020, jepet në vijim.

Strukturat arkëtuese të të ardhurave për Bashkinë Tiranë, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Strukturat e Bashkisë
- Institucionet e varësisë
- Agjentët tatimorë

### DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, planin vjetor për vitin 2020 për 4,603,135,000 lekë e ka realizuar në masën 3,524,816,092 lekë ose 77%.

#### A. Taksa mbi ndërtesën


Të dhënat e realizimit 2020, për takson mbi ndërtesat e subjekteteve të biznesit, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë %
Taksa mbi ndërtesën e Subjekteve të biznesit	1,902,010,000	1,380,326,027	73%

Gjatë vitit 2020 kjo takson ka pasur një ulje në krahasim me vitin e mëparshëm për kategorinë biznese për shkak se një pjesë e mirë e bizneseve duke qenë se nuk kanë funksionuar gjatë periudhës së pandemisë kanë pasur probleme me likuiditetin, shumë biznese të vogla janë mbyllur, ndërsa për kategorinë familjarë shohim një rritje me shumë se 2-fishi në krahasim nga viti 2019.

Taksa mbi ndërtesën	2017	2018	2019	në lekë 2020
Familjare	216,542,796	228,647,177	233,353,993	536,606,757
Biznesi	1,457,892,780	1,586,349,438	1,605,209,838	1,380,326,027
Totali	1,674,435,576	1,814,996,615	1,838,563,831	1,916,932,784

Grafikisht:



Nga 1 Prilli i vitit 2018 e në vazhdim gjatë vitit 2019 ka filluar të mblidhet taksa e ndërtesës në bazë të ndryshimeve që i janë kryer ligjit mbi taksat vendore në bazë të VKM nr.132 datë

07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënavë për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriteret dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” dhe ndryshimeve që i janë kryer kësaj VKM me VKM nr.168 datë 27.03.2019 dhe VKM 144 datë 03.02.2020.

Numri i njësive të pronës aktive të regjistruara për taksën e ndërtesës në lidhje me subjektet e biznesit jepet si më poshtë:

<b>Tipologjia e paguesit të taksës</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Individë	27,213	28,598	29,542	29,972
Biznes i madh	3,164	3,678	4,126	4,457
Biznes i vogël	8,627	8,692	8,684	8,573
VIP	1410	1587	1682	1734
Të tjera	2,821	2,735	2,681	2,658
<b>Totali</b>	<b>43,235</b>	<b>45,290</b>	<b>46,715</b>	<b>47,394</b>

Ndërkohë, Ujësjellës Kanalizime Tiranë, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave nga kategoria “Familjarë”, çdo muaj përgatit akt rakordimin mbi evidentimin e familjeve likuiduese të detyrimit dhe atyre përfituese të lehtësirave fiskale si dhe vlerën përkatëse që duhet t’i xhirojë Bashkisë Tiranë.

Problematikat në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë vazhdojnë të mbetet mos saktësimi i sipërfaqeve reale dhe faturimi i një pjese të abonentëve me sipërfaqe të prezumuar si dhe regjistrimi si abonentë për taksën e ndërtesës për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjellës Kanalizimin Tiranë sh.a.

Njësitë Administrative, të cilat kanë bërë më parë mbledhjen e kësaj takse, nuk disponojnë informacion të saktë për evidentimin e tyre dhe si rrjedhojë këto familje nuk janë njoftuar nga UKT sh.a, për detyrimin që kanë ndaj Bashkisë së Tiranës dhe situata e pandemisë ka vështirësuar procesin e evidentimit në terren si pasojë e kushteve të distancimit social.

#### A. Taksa mbi tokën bujqësore

Të dhënat e realizimit për vitin 2020 për taksën mbi tokën bujqësore nga të gjitha kategoritë disponuese të tokës, paraqitet si më poshtë:

<b>Emërtimi</b>	<b>Plani 2020</b>	<b>në lekë</b>	
		<b>Fakti 2020</b>	<b>%</b>
Taksa mbi tokën bujqësore	50,000,000	21,207,054	42%

Ndër problemet kryesore të hasura gjatë këtij viti në lidhje me të ardhurat nga kjo taksë, vijon të jetë mungesa e bazës së të dhënavë prej regjistrave të tokës bujqësore nga Njësitë

Administrative (ish-Komunat).

Fakti i diferencës së njësive aktive me ato likuiduese tregon për mos azhornim të situatës në terren dhe mos ndjekjen e njësive mospaguese të detyrimit të kësaj takse.

në lekë

Kat. e tokës	Nj. aktive të tarifuara	Nj. likuiduese	Sipërf. aktive e tarifuar	Sipërf. likuiduese
Kategoria I	2,224	1,214	640	359
Kategoria II	5	4	1	1
Kategoria III	1,510	678	988	430
Kategoria IV	1,456	602	832	332
Kategoria V	4,505	1,680	2,849	987
Kategoria VI	4,458	1,348	3,510	1,012
Kategoria VII-X	3,044	677	1,706	351
<b>Totali</b>	<b>17,202</b>	<b>6,203</b>	<b>10,525</b>	<b>3,473</b>

Problemet kryesore të hasura këto vitet e fundit në lidhje me këtë taksë janë:

- Mungon informacion i plotë për ngastrat e tokës bujqësore nga NJA;
- Regjistimet e kryera nga inspektorët e terrenit në disa ish komuna kanë mangësi për emrat, sipërfaqjet dhe kategoritë.
- Ndryshime në llojin e tokës, raste kur me dokumenta figuron tokë bujqësore dhe në fakt është kthyer në truall.

Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Taksa mbi token bujqësore	22,667,724	22,757,271	20,299,189	21,207,054

#### A. Taksa mbi truallin

Taksa mbi truallin, ka të bëjë me truallin e përdorur për banesë dhe për biznes. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2020, janë realizuar në shumën 50,714,059 lekë, kundrejt planit 60,000,000 lekë, pra kemi një realizim prej 85%.

Problemi kryesor që lidhet me të ardhurat nga kjo taksë, është mungesa e informacionit në lidhje me pronësinë e truallit, ndaj del e nevojshme që të krijohet një regjistër elektronik, me të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit por dhe nga Drejtoritë Rajonale të Tiranës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke vlerësuar dosjet ekzistuese dhe azhornimin e tyre.

Të dhënat e realizimit për vitin 2020, për taksën mbi truallin, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa mbi truallin	60,000,000	50,714,059	85%

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e taksës mbi truallin është DPTTV në bashkëpunim me Njësitë Administrative. Të ardhurat nga kjo taksë kanë pasur një realizim te afërt krahasuar me planifikimin. Edhe në këtë rast mungesa e regjistrat të pronave truall në Njësitë Administrative, sjell vështirësi në evidentimin e saktë të potencialit të të ardhurave, shtuar këtu faktin se është një taksë e re dhe nuk janë vendosur ende të gjithë mekanizmat e mbledhjes së saj.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë mbështetet tek evidentimi i njësive aktive dhe njësive likuiduese, të cilat për vitin 2020, paraqiten si më poshtë:

	Njësi Aktive të Tarifuar	Njësi Likuiduese	Sipërfaqe Aktive të Tarifuar	Sipërfaqja Likuiduese
Truall për qëllime banimi	2,015	474	693,253	214,505
Truall për qëllime biznesi	2,464	1,606	3,245,252	2,415,271
Totali	4,479	2,080	3,938,505	2,629,777

Problemet e konstatuara gjatë vitit 2020, janë:


- Mungesa e informacionit të plotë mbi pronësinë e truallit, në territorin e Bashkisë Tiranë.
- Mos shfrytëzimi i burimeve materiale por dhe mos azhornimi ne tërësi me territorin nga strukturat e ngarkuara.

Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	në lekë
Taksa mbi truallin	52,741,453	55,345,234	56,079,090	50,714,059	

Grafikisht të dhënat e mësipërme të realizimit në vite:

Taksa mbi truallin



#### A. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel është një detyrim mëjor që evidentohet çdo fund-muaji nga pagesat e njësive akomoduese.

Gjatë vitit 2020, janë evidentuar gjithsej 338 njësi hotelerie nga të cilat 7 janë me nivelin e taksës 350 lekë/dhoma dhe 331 njësi me nivelin e taksës 140 lekë/dhoma.

Për vitin 2020, janë realizuar të ardhura në shumën 35,815,582 lekë kundrejt planit për 100,000,000 lekë.

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë %
Taksa e fjetjes në hotel	100,000,000	35,815,582	36%


Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për sektorin e hotelisë. Ecuria e kësaj takse këtë vit është impaktuar nga mbyllja e aktivitetit për disa muaj dhe mos levizja e lirë e qytetarëve në kuadër të masave të marra në kushtet e pandemisë Covid-19.

Realizimi i taksës së fjetjes në hotel për 4 vitet e fundit është paraqitur më poshte:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Taksa e fjetjes në hotel	83,170,711	98,004,072	113,966,275	35,815,582

Grafikisht paraqitur më poshtë realizmi i taksës së fjetjes në hotel:

Taksa e fjetjes në hotel



## B. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet mbi llojet e tabelave të mëposhtëme:

- Tabelë për qëllime identifikim/sinjalizimi;
- Tabelë për qëllime identifikimi deri 2 m<sup>2</sup>, 2-10 m<sup>2</sup>, 10-20 m<sup>2</sup>, 20-40 m<sup>2</sup>, mbi 40 m<sup>2</sup>
- Tabelë për qëllime reklamimi;
  
- Tabela për qëllime identifikim/sinjalizimi vendozet jashtë territorit të aktivitetit të biznesi për të orientuar blerësit për vendndodhjen e biznesit, me sipërfaqe nën 2 m<sup>2</sup>.
  
- Tabela për qëllime identifikimi deri 2 m<sup>2</sup>, 2-10 m<sup>2</sup>, 10-20 m<sup>2</sup>, 20-40 m<sup>2</sup>, mbi 40 m<sup>2</sup> janë tabelat e trupëzuara ose jo brenda territorit ku zhvillohet aktiviteti i biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimitaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)
  
- Tabelat për qëllime reklamimi e lëvizshme apo e palëlëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup>.

Gjatë vitit 2020 janë arkëtuar gjithsej 236,214,879 lekë ndaj planit prej 320,255,000 leke.

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë
Tabelë identifikuuese/ sinjalizuese	255,000	78,523	31%
Tabelë reklamuuese	320,000,000	236,136,356	74%
<b>Taksa e tabelës</b>	<b>320,255,000</b>	<b>236,214,879</b>	<b>74%</b>


Për vitin 2020, realizimi i të ardhurave nga kjo taksë, ka pësuar një renie në krahasim me vitet e kaluara duke marrë parasysh se një pjesë e aktiviteteve që reklamojnë biznesin diskoteka, klube, kafe, pishina dhe komplekse sportive e kanë pasur të pezulluar aktivitetin.

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet si më poshtë:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Tabele	419,267	181,702	180,634	78,523
Reklame	345,510,765	307,697,673	268,022,505	236,136,356
<b>Totali</b>	<b>345,930,032</b>	<b>307,879,375</b>	<b>268,203,139</b>	<b>236,214,879</b>

Grafikisht realizimi i taksës së tabelës dhe reklamës ne vite paraqitet më poshtë:

### Taksa e tabelës dhe reklamës



#### A. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore është një taksë e përkohshme për një periudhë 7-vjeçare. Të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë për vitin 2020 janë në masën 80% ndaj planit. Kjo rënie në nivelin e realizimit është impaktuar nga ulja e aftësisë paguese të subjekteve tregtare në krahasim me vitin 2019 dhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore	808,021,000	649,392,794	80%

Më në detaj sipas dy nëndarjeve të mëdha për subjektet “Familjarë” dhe subjektet “Biznesi” paraqitet realizimi i të ardhurave kundrejt planit si me poshtë:

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore subjektet “Familjarë”	313,571,000	288,293,159	92%

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksë e përkohshme për infrastrukturën arsimore subjektet "Biznes"	494,450,000	361,099,635	73%

Në tabelë më poshtë pasqyrohen njësitë aktive të tarifuara, detyrimi respektivë vjetor, njësitë likuiduese dhe vlera e likuiduar sipas klasifikimit të madhësisë së biznesit dhe të tjera për vitin 2020:

Klasifikimi	Nj. aktive të tarifuara	Detyrimi vjetor	Nj.likuiduese	Vlera e likuiduar
Njësi BV	43,516	131,517,679	28,066	86,044,711
Njësi BM	14,831	279,572,748	11,440	212,142,777
Njësi VIP	2,456	56,837,169	1,717	49,911,217
Nj.të tjera + Shtetërore	2,120	10,374,917	1,376	6,725,326
<b>Totali</b>	<b>62,923</b>	<b>478,302,512</b>	<b>42,599</b>	<b>354,824,032</b>

Krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore që ndjek dhe arkëton taksën nga kategoria "Biznes", është dhe Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a e cila faturon dhe arkëton detyrimin e taksës për kategorinë "Familjarë".

Gjatë vitit 2020, nga Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a është arkëtuar vlera prej 288,293,159 lekë nga kjo taksë, e cila ka kaluar në favor të Bashkisë Tiranë për çdo muaj pas arkëtimit, si më poshtë:

Taksë e përkohshme për infrastrukturën arsimore				
Muaji	Akt-rakordimi mujor	Likuiduar	Nr. familjeve paguese	Nr. përjashtimeve të reja/muaj
Janar	25,061,865	25,564,284	131,336	2,818
Shkurt	24,383,217	25,061,865	130,886	3,368
Mars	18,600,754	0	104,797	1,704
Prill	24,318,351	44,668,988	130,617	353
Maj	23,854,136	24,318,351	130,582	372
Qershor	24,036,623	23,854,136	130,605	465
Korrik	24,493,450	24,036,623	130,605	592
Gusht	23,660,389	24,493,450	125,314	406
Shtator	24,418,967	23,660,389	125,309	377
Tetor	24,988,295	24,418,967	125,334	423
Nëntor	23,227,811	24,988,295	125,217	496
Dhjetor	25,971,561	23,227,811	125,424	349
<b>Total</b>	<b>287,015,419</b>	<b>288,293,159</b>	<b>126,336</b>	<b>11,723</b>

Realizimi ndër vite i taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore paraqitet si më poshtë:

	në lekë			
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore	2017	2018	2019	2020
Familjarë	266,244,300	286,498,987	274,551,161	288,293,159
Biznesi	415,682,866	443,596,174	425,221,988	361,099,635
<b>Totali</b>	<b>681,927,166</b>	<b>730,095,161</b>	<b>699,773,149</b>	<b>649,392,794</b>

#### A. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, bën zbardhjen e lejes kundrejt arkëtimit të vlerës së taksës në masën e llogaritur. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2020 janë realizuar në masën 134% kundrejt planit të miratuar.  
në lekë


Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,753,000,000	6,350,959,457	134%

Viti 2020 rezulton si viti i suksesshëm për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, duke arritur vlerën më të lartë të arkëtar krahasuar me vitet e kaluara, si më poshtë:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3,334,882,679	5,398,328,978	6,315,307,289	6,350,959,457

Grafikisht realizimi ndër vite paraqitet si më poshtë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë



#### TARIFAT

##### A. Tarifa e pastrimit.

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Nga të dhënrat bazuar në arkëtimet shihet se të ardhurat janë realizuar në masën 91% për subjektet e biznesit.

			në lekë
Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Biznesi"	1,336,866,000	1,215,758,389	91%

Tarifa e pastrimit për kategorinë "Familjare", për vitin 2020 është realizuar në masën 93%. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020 janë arkëtuar rregullisht detyrimet për tarifën e pastrimit nëpërmjet faturës së ujit. Numri mesatar i familjeve likujduese është 126,396 familje, pa përfshirë familjet e përjashtuara.


			në lekë
Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Familjare"	779,440,000	726,552,679	93%

Ecuria e arkëtimit të tarifës së pastrimit për të dyja kategoritë si Biznese dhe Familjare është në trend rritës krahasuar me vitet e mëparshme si rezultat i riorganizimit të mënyrës së mbledhjes së tarifës por dhe angazhimit të strukturave menaxhuese, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia.

	2017	2018	2019	2020
Tarifa e pastrimit "Familjare"	660,070,341	743,133,619	651,984,449	726,552,679
"Biznesi"	1,055,409,334	1,141,146,525	1,138,546,202	1,215,758,389
<b>Total</b>	<b>1,715,479,675</b>	<b>1,884,280,144</b>	<b>1,790,530,651</b>	<b>1,942,311,068</b>

Grafikisht të ardhurat e realizuara për katër vitet e fundit paraqiten si më poshtë:

**Tarifa e pastrimit**



**C. Tarifa për zënien e hapësirave publike.**

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup> e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj.
- Zënia e hapësirës publike ne tregjet publike.

Taksa për zënien e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj faturohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me njësitet administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë, për çdo rast të përdorimit të hapësirave publike kundrejt një takse mujore sipas ndarjes zonale të miratuar me nivele që vijnë duke u ulur me largimin nga qendra, nga 1.500 leke/m<sup>2</sup>/muaj deri ne 200 leke/m<sup>2</sup>/muaj.

Duhet theksuar gjithashtu se për shkak të situatës së krijuar dhe të masave të marra në kuadër të pandemisë Covid-19 me VKB 28 datë 24.03.2020, i ndryshuar me VKB 60, datë 01.06.2020 është vendosur përjashtimi nga pagesa e shfrytëzimit të tarifës së zënies së hapsirës publike për periudhën mars-prill 2020 për të gjitha aktivitetet dhe për aktivitetet e bar-restaurant per periudhën maj-qershor 2020.

Të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirave publike për vitin 2020 janë në vlerën 223,680,468 lekë.

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangiella	264,000,000	208,475,434	79%
Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	20,000,000	15,205,034	76%
<b>Totali</b>	<b>284,000,000</b>	<b>223,680,468</b>	<b>79%</b>


Pjesa më e madhe e të ardhurave të gjeneruara nga tarifa për zënien e hapësirës publike vijnë nga Vëmendja kryesore është përqëndruar tek Tarifa për zënien e hapsirës publike me platforma , kangiella etj.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike nga viti 2017 deri në vitin 2020 jepen si mëposhtë:

Emërtimi	2017	2018	2019	në lekë 2020
Tarifa për zënien e hapësirave publike	345,627,823	386,489,538	385,666,800	223,680,468

Grafikisht të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e zënies së hapësirës publike në vite paraqiten si më poshtë:

**Tarifa e për zënien e hapësirave publike**



Probleme të konstatuara, janë:

- Mos deklarimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim nga ana e subjekteve;
- Mos azhornimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim për mosangazhimin e duhur nga strukturat e ngarkuara;

#### **D. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime.**

Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, për çdo aplikim për leje zhvillimi, infrastrukturë dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Vlera e planifikuar për t'u arkëtuar gjatë vitit 2020 ishte 368,000,000 lekë e cila u realizua në masën 162 % ose 594,764,275 lekë. Rritja e arkëtimeve nga kjo tarifë për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 është ndikuar nga shtimi i lejeve të ndërtimit për këtë vit.


			në lekë
Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	368,000,000	594,764,275	162%

Realizimi i kësaj tarife ndër vite paraqiten sim poshtë:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	në lekë
Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	188,375,674	462,929,640	477,529,142	594,764,275	

Grafikisht ecuria e kësaj tarife ndër vite paraqitet si më poshtë:

**Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime**



## **TIRANA PARKING**

### **A. Tarifa e parkimit.**

Tarifa për parkimin e automjetave në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Tiranës për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për takxitë e liçensuara.

Për vitin 2020, arkëtimet nga tarifat e parkimit sipas natyrës së tarifimit të parkimit krahasuar me planin vjetor, është realizuar si më poshtë:


Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë %
<b>Parkim me kontrate</b>	<b>154,000,000</b>	<b>149,079,620</b>	<b>97%</b>
<b>Parkim me biletë</b>	<b>463,200,000</b>	<b>250,936,040</b>	<b>54%</b>
<b>Ne sheshe</b>	<b>240,000,000</b>	<b>154,526,220</b>	<b>64%</b>
<b>SMS - Parking</b>	<b>223,200,000</b>	<b>96,409,820</b>	<b>43%</b>
<b>Totali</b>	<b>617,200,000</b>	<b>400,015,660</b>	<b>65%</b>

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2020 ka qënë më i ulët, duke marrë parasysh vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme nga pandemia Covid-19 dhe limitimit të lëvizjes për një periudhë 3 mujore.

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Tarifa e parkimit	338,295,014	454,788,832	469,401,688	400,015,660

Grafikisht realizimi i tarifës së parkimit në vite paraqitet si më poshtë:

**Tarifa e parkimit në vite**



## **INSTITUCIONE TË TJERA**

### **DREJTORIA TATIMORE RAJONALE TIRANË**

#### **A. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.**

Viti 2020 është vitit i fundit i aplikimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Duke nisur nga viti

2021 bizneset që realizojnë gjatë vitit një qarkullim deri në 14,000,000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, do ta kenë shkallën tatimore mbi fitimin është 0 (zero).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse vendore deri në momentin e aplikimit të saj është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me të cilën Sektori i Agjenteve tatimore pranë DPTTV, çdo muaj kryen rakordimin e të ardhurave të realizuara.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga ky tatim për vitin 2020, paraqitet si mëposhtë:

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë %
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël	176,000,000	206,546,516	117%

Evidentimi i arkëtimeve të TTHF e BV për çdo muaj të vitit 2020, paraqitet si më poshtë:

Periudha	Total	Akt rakordimi	Bashkia Tiranë (99%)	Dr. Tatimeve 1%
Akt Rakordimi Nr.12 dt.20.01.2020 per periudhen 01/12 - 31/12/2019	3,250,817	3,218,309	32,508	
Akt Rakordimi Nr.1 dt.03.03.2020 per periudhen 01/01 - 31/01/2020	12,789,932	12,662,033	127,899	
Akt Rakordimi Nr.2 dt.18.03.2020 per periudhen 01/02 - 29/02/2020	148,857,605	147,369,029	1,488,576	
Akt Rakordimi Nr.3 dt.15.04.2020 për periudhen 01/03 - 31/03/2020	11,144,307	11,032,864	111,443	
Akt Rakordimi Nr.4 dt.11.05.2020 per periudhen 01/04 - 30/04/2020	8,150,178	8,068,676	81,502	
Akt Rakordimi Nr.5 dt.15.06.2020 per periudhen 01/05 - 31/05/2020	4,210,964	4,168,854	42,110	
Akt Rakordimi Nr.6 dt.06.07.2020 per periudhen 01/05 - 30/06/2020	3,911,960	3,872,840	39,120	
Akt Rakordimi Nr.7 dt.06.08.2020 per periudhen 01/07 - 31/07/2020	2,165,084	2,143,433	21,651	
Akt Rakordimi Nr.8 dt.08.09.2020 per periudhen 01/08 - 31/08/2020	3,737,973	3,700,593	37,380	
Akt Rakordimi Nr.9 dt.06.10.2020 per periudhen 01/09 - 30/09/2020	4,654,925	4,608,376	46,549	
Akt Rakordimi Nr.10 dt.09.11.2020 per periudhen 01/10 - 31/10/2020	2,490,253	2,465,350	24,903	
Akt Rakordimi Nr.11 dt.07.12.2020 per periudhen 01/11 - 30/10/2020	1,182,518	1,170,693	11,825	
<b>Totali</b>	<b>206,546,516</b>	<b>204,481,051</b>	<b>2,065,465</b>	

Kalimi i 1% që përfaqëson vlerën e agjentit tatimor, (DPT) ekzekutohet vetëm pas miratimit me vendim të Këshillit Bashkiak, si përdorim të ardhurash.

Ecuria ndër vite e këtij tatimi paraqitet si vijon:

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	në lekë
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin përbiznesin e vogël	137,752,837	156,413,623	171,559,116	206,546,516	

## AGJENCIA E KADASTRËS SHTETËRORE

### A. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Agjencia e Kadastrës Shtetërore. Nga rakordimet e bëra me ZVRPP, nga Sektori i Agjentëve Tatimorë, realizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2020, është 114% e planit vjetor siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme:


Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	320,000,000	365,273,593	114%

Ecuria ndër vite e kësaj takse paraqitet si vijon:

Emërtimi	2017	2018	2019	në lekë 2020
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	299,939,349	326,192,912	326,363,132	365,273,593

Grafikisht realizimi i kësaj takse paraqitet si më poshtë:

**Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**



## DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR

### A. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Agjenti tatimor i kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor e cila çdo muaj krashtas kontrollit teknik, realizon edhe arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të

përdorura nga e cila i kalon Bashkisë 18% të shumës së arkëtar, pasi ka zbritur 5% e përfituar si agjent tatimor.

Sipas akt rakordimeve mujore të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Vendore dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, rezulton se krahas të ardhurave të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura është evidentuar dhe numri i mjeteve që kanë likujduar këtë taksë, si më poshtë:

Muaji	Nr. mjeteve	Vlera e arkëtar dhe kaluar për Bashkinë Tiranë
Dhjetori 2019	19,551	65,858,079
Janar	12,723	37,666,232
Shkurt	11,743	32,512,781
Mars	4,837	13,540,086
Prill	7,886	21,650,188
Maj	15,919	39,945,191
Qershor	17,056	44,723,801
Korrik	16,900	44,827,077
Gusht	14,068	36,856,799
Shtator	13,261	33,780,827
Tetor	14,327	37,410,203
Nentor	12,914	33,941,731
<b>Totali</b>	<b>161,185</b>	<b>442,712,995</b>

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2020 është në masën 105%, ashtu si paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	%
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	420,000,000	442,712,995	105%


Ecuria ndër vite e këtij treguesi paraqitet si vijon:

në lekë

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	285,325,027	406,962,488	433,146,135	442,712,995

Grafikisht realizimi i kësaj taksë paraqitet si më poshtë:

**Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**



### **TË ARDHURA NGA DREJTORIA E PERGJITHSHME E CERDHE DHE KOPSHTeve DHE KONVIKTET.**

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila llogaritet nga tarifa ditore për ushqimin dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë muajit.

Realizimi i arkëtitimit të ketyre pagesave, për vitin 2020, është si më poshtë:

Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	në lekë
Të ardhura nga Kopshtet	143,000,000	89,124,960	62%
Të ardhura nga Çerdhet	78,500,000	50,759,970	65%
Të ardhura nga Konviktet	6,500,000	4,572,310	70%

Investime e kryera nga Bashkia Tiranë në drejtim të të përmirësimit të kushteve por dhe në rritjen e kapaciteteve në kopshtet e çerdhet e Tiranës janë reflektuar edhe në rritjen e ndjeshme të frekuentimit të fëmijëve në këto institucione për pasojë edhe në rritjen e të ardhurave prej tyre. Mbetet akoma punë për rritjen e kapaciteteve për këto institucione që diktohet nga kërkuesat e pafundme të prindërve që kërkojnë rregjistrimin e fëmijëve të tyre për frekuentimin në kopshtet e çerdhet publikë, falë kushteve të mira për mirërritjen e fëmijëve por dhe konkuruase me subjektet private që aplikojnë kosto të larta.

Viti 2020 ka pasur një ulje të të ardhurave të mbledhura nga këto aktivitete si pasojë e ndalimit të frekuentimit të këtyre ambienteve në bazë të akteve normative.

Ecuria ndër vite e këtyre të ardhurave paraqitet si vijon:

Emërtimi	2017	2018	2019	në lekë 2020
Të ardhura nga Kopshtet	112,529,983	119,123,817	128,533,229	89,124,960
Të ardhura nga Çerdhet	60,432,581	69,329,019	74,912,390	50,759,970
Të ardhura nga Konviktet	5,747,030	6,744,125	6,103,881	4,572,310

## KAPITULLI II

### *Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020*


Bashkia Tiranë gjatë kesaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 28 programeve buxhetore, bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjt për qeverisjen vendore, konkretisht:

- 
1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
  2. Programi Ceshtje Financiare & Fiskale

3. Programi Pagesa per sherbimin e borxhit te brendshem
4. Programi Sherbimet e Policise Vendore
5. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
6. Programi Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik
7. Programi Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
8. Programi Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve
9. Programi Menaxhim i Infrastruktures se Ujites & Kullimit
10. Programi Administrimi I Pyjeve & Kullotave
11. Programi Rrjeti Rrugor
12. Programi Transporti Publik
13. Programi Projekte Zhvillimi
14. Programi Zhvillimi i Turizmit
15. Programi Menaxhim i Mbetjeve
16. Programi Strehimi Lokal & Urbanistika
17. Programi Programet e Zhvillimit
18. Programi Sherbimet Publike Vendore
19. Programi Ndricim Rrugesh
20. Programi Sport dhe Argetim
21. Programi Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
22. Programi Arsimi baze perfshire arsimin parashkollar
23. Programi Arsimi i Mesem i Pergjithshem
24. Programi Arsimi Profesional
25. Programi Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar
26. Programi Kujdesi Social per familjet & femijet
27. Programi Papunesia, Arsim & Aftesim Profesional
28. Programi Strehim Social

Buxheti i rishikuar i Bashkisë Tiranë për vitin 2020 është 33,951,456,681.51 lekë. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Buxheti i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Sic vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programet e Arsimi Baze perfshire Arsimin Parashkollor si dhe Arsimi i Mesem Pergjithshem (15%)
  - Programi i Rrjeti Rrugor (12%)
  - Programi i Sherbime Publike Vendore (12%)
  - Programi i Strehim Lokal dhe Urbanistika (10%)
  - Programet e Zhvillimit (5%)
- **Shpenzimet sipas klasifikimi ekonomik**

Në total Bashkia Tiranë ka një realizim prej 72% të planit te vitit 2020.

Referuar klasifikimit ekonomik realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar 87%,
- shpenzimet operative 83%
- shpenzimet kapitale 54%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti viti 2020	Realizimi ne %
-------------------------------	------------	-----------------	----------------

<i>Shpenzime personeli</i>	6,173,895,390	5,376,808,868	87%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	14,137,426,156	11,779,488,479	83%
<i>Shpenzime kapitale</i>	13,640,135,136	7,365,316,658	54%
<i>Totali</i>	<b>33,951,456,682</b>	<b>24,521,614,005</b>	<b>72%</b>

- **Shpenzimet sipas burimeve të financimit**

Shpenzimet sipas Burimeve të financimit për vitin 2020, paraqiten si më poshtë:

<b>Shpenzimet sipas klasifikimit</b>	<b>Plani 2020</b>	<b>Fakti viti 2020</b>	<b>Realizimi ne %</b>
<i>Te ardhura BT</i>	19,380,744,810	14,764,405,599	76%
<i>Transferta e Pakushtezuar +Sektoriale</i>	4,255,023,696	3,345,123,522	79%
<i>Transferta e pakushtezuar/ Rindertimi</i>	5,919,649,980	2,154,086,563	36%
<i>Transferta e Kushtezuar</i>	4,267,446,916	4,200,855,263	98%
<i>Donacione</i>	128,591,280	57,143,058	44%
<i>Totali</i>	<b>33,951,456,682</b>	<b>24,521,614,005</b>	<b>72%</b>

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin e vitit 2020 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 14,764,405,599 lekë e cila përbën 60% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 14 % të burimeve të financimit, fondet e kushtëzuara zënë 17% të strukturës së burimeve të financimit.

- **Shpenzimet sipas klasifikimit në programe**

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të vitit 2020 në bazë programesh.

<b>Emertimi</b>	<b>Plani 2020</b>	<b>Fakti 2020</b>	<b>%</b>
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	3,317,968,897	2,562,760,225	77%
<i>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</i>	330,499,000	293,335,161	89%
<i>Pagesa per sherbimin e borxhit te brendshem</i>	338,767,306	-	0%
<i>Sherbimet e Policise Vendore</i>	488,642,000	404,307,865	83%
<i>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</i>	2,184,638,892	1,729,899,356	79%
<i>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</i>	78,000,000	13,667,047	18%
<i>Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</i>	96,950,106	51,319,215	53%
<i>Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	376,384,766	288,373,009	77%
<i>Menaxhim I Infrastrukturës se Ujites &amp; Kullimit</i>	55,825,321	20,392,907	37%

<b>Administrimi i Pyjeve &amp; Kullotave</b>	9,696,493	9,008,889	93%
<b>Rrjeti Rrugor</b>	3,941,348,268	3,450,958,985	88%
<b>Transporti Publik</b>	322,211,217	189,029,286	59%
<b>Projekte Zhvillimi</b>	38,486,047	23,861,282	62%
<b>Zhvillimi i Turizmit</b>	23,230,000	14,207,246	61%
<b>Menaxhim i Mbetjeve</b>	2,895,956,111	2,676,105,600	92%
<b>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</b>	3,296,808,031	1,350,145,403	41%
<b>Programet e Zhvillimit</b>	1,710,484,042	275,250,335	16%
<b>Sherbimet Publike Vendore</b>	4,066,038,605	3,055,933,233	75%
<b>Ndricim Rrugesh</b>	326,000,000	275,997,340	85%
<b>Sport dhe Argetim</b>	319,491,598	272,278,560	85%
<b>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</b>	685,846,243	479,776,504	70%
<b>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollar</b>	3,402,753,365	2,253,997,264	66%
<b>Arsimi i mesem i pergjithshem</b>	1,824,334,642	1,263,199,100	69%
<b>Arsimi profesional</b>	156,289,510	117,803,679	75%
<b>Kujdesi Social per personat e semure &amp; me aftesi te kufizuar</b>	17,400,000	17,057,150	98%
<b>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</b>	3,489,403,287	3,354,415,616	96%
<b>Papunesia, Arsim &amp; Aftesim profesional</b>	27,730,610	13,237,664	48%
<b>Strehim Social</b>	130,272,325	65,296,084	50%
<b>TOTAL</b>	<b>33,951,456,682</b>	<b>24,521,614,005</b>	<b>72%</b>

-**Programi i Rrjeti Rrugor** i cili përbën 12% të buxhetit vjetor dhe realizimi i tij për vitin 2020 është 88%.

-**Programi i Shërbimeve Publike Vendore** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe ka një realizim vjetor prej 75% ne vitin 2020.

-**Programi i Arsim Baze dhe Parashkollar** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 66% ne vitin 2020.

-**Programi i Strehimit Lokal dhe Urbanistika** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 41% të vitit 2020.

-**Programet e Zhvillimit** i cili perben 5% te buxhetit per vitin 2020 qe ka te beje me fondet per rindertimin nga termetet e vitit 2019.

- Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik**

Shpenzimet korente dhe kapitale për çdo funksion sipas programeve dhe nga të gjitha burirnet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Emertimi	SHPENZIME KORENTE			SHPENZIME KAPITALE		
	Plan 2020	Fakti 2020	%	Plan 2020	Fakti 2020	%
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	3,165,543,963	2,506,034,512	79%	152,424,934	56,725,713	37%
<i>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</i>	327,557,000	290,921,861	89%	2,942,000	2,413,300	82%
<i>Pagesa per sherbimin e bërxhit te brendshem</i>	338,767,306		0%			
<i>Sherbimet e Policise Vendore</i>	481,982,000	404,307,865	84%	6,660,000		0%
<i>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</i>	2,031,654,317	1,594,959,906	79%	152,984,575	134,939,450	88%
<i>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</i>	78,000,000	13,667,047	18%			
<i>Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</i>	65,838,000	51,319,215	78%	31,112,106		0%
<i>Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	363,324,766	284,542,081	78%	13,060,000	3,830,928	29%
<i>Menaxhim i Infrastrukturës se Ujites &amp; Kullimit</i>	20,496,028	20,392,907	99%	35,329,293		
<i>Administrimi i Pyjeve &amp; Kullotave</i>	9,696,493	9,008,889	93%			
<i>Rrjeti Rugor</i>	959,684,885	874,560,640	91%	2,981,663,383	2,576,398,345	86%
<i>Transporti Publik</i>	205,959,000	158,629,744	77%	116,252,217	30,399,542	26%
<i>Projekte Zhvillimi</i>	16,693,017	2,750,705	16%	21,793,030	21,110,577	97%
<i>Zhvillimi i Turizmit</i>	23,230,000	14,207,246	61%			
<i>Menaxhim i Mbetjeve</i>	2,895,956,111	2,676,105,600	92%			
<i>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</i>	185,512,550	134,052,387	72%	3,111,295,481	1,216,093,016	39%
<i>Programet e Zhvillimit</i>	42,000,000	13,938,478	33%	1,668,484,042	261,311,857	16%
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	1,222,695,200	1,138,633,169	93%	2,843,343,405	1,917,300,064	67%
<i>Ndricim Rrugesh</i>	326,000,000	275,997,340	85%			
<i>Sport dhe Argetim</i>	251,900,350	224,974,443	89%	67,591,248	47,304,117	70%
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	549,119,225	446,282,216	81%	136,727,018	33,494,288	24%
<i>Arsimi haze perfshire arsimin</i>			81%			49%

<b>parashkollar</b>	<b>1,833,147,888</b>	<b>1,492,001,827</b>		<b>1,569,605,477</b>	<b>761,995,437</b>	
<b>Arsimi i mesem i per gjithshem</b>	<b>1,156,350,827</b>	<b>991,909,896</b>	<b>86%</b>	<b>667,983,815</b>	<b>271,289,204</b>	<b>41%</b>
<b>Arsimi profesional</b>	<b>154,289,510</b>	<b>117,803,679</b>	<b>76%</b>	<b>2,000,000</b>	-	<b>0%</b>
<b>Kujdesi Social per personat e semure &amp; me aftesi te kufizuar</b>	<b>17,400,000</b>	<b>17,057,150</b>	<b>98%</b>			
<b>Kujdesi Social per familjet &amp; fernijet</b>	<b>3,451,498,032</b>	<b>3,344,116,364</b>	<b>97%</b>	<b>37,905,255</b>	<b>10,299,252</b>	<b>27%</b>
<b>Papunesia, Arsim &amp; Aftesim profesional</b>	<b>27,730,610</b>	<b>13,237,664</b>	<b>48%</b>			
<b>Strehim Social</b>	<b>109,294,468</b>	<b>44,884,516</b>	<b>41%</b>	<b>20,977,857</b>	<b>20,411,568</b>	<b>97%</b>
<b>TOTAL</b>	<b>20,311,321,546</b>	<b>17,156,297,347</b>	<b>84%</b>	<b>13,640,135,136</b>	<b>7,365,316,658</b>	<b>54%</b>

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat duke iu referuar Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022 të miratuar me VKB nr 157 date 26.12.2019 dhe në vazhdim, planit për buxhetin vjetor te miratuara me kete vendim, si dhe për kete periudhe vjetori 2020 planin dhe faktin.

Emertimi	PBA 2020	Plan I rishikuar 2020	Fakti 2020
<b>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</b>	<b>2,714,868,330</b>	<b>3,195,419,930</b>	<b>2,468,899,675</b>
<b>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</b>	<b>323,999,000</b>	<b>330,499,000</b>	<b>293,335,161</b>
<b>Pagesa per sherbimin e borkxit te brendshem</b>	<b>338,767,306</b>	<b>338,767,306</b>	
<b>Sherbimet e Policise Vendore</b>	<b>470,482,000</b>	<b>488,642,000</b>	<b>404,307,865</b>
<b>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</b>	<b>634,632,940</b>	<b>653,793,885</b>	<b>500,292,765</b>
<b>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</b>	<b>78,000,000</b>	<b>78,000,000</b>	<b>13,667,047</b>
<b>Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</b>	<b>96,950,106</b>	<b>96,950,106</b>	<b>51,319,215</b>
<b>Sherbimet Buqesore, Inspektimi, Siguria Ushq &amp; Mbrojtja e Konsumat</b>	<b>363,244,766</b>	<b>376,384,766</b>	<b>288,373,009</b>
<b>Menaxhim i Infrastrukturës se Ujites &amp; Kullimit</b>	<b>20,429,976</b>	<b>55,825,321</b>	<b>20,392,907</b>
<b>Administrimi i Pyjeve &amp; Kullotave</b>	<b>9,050,054</b>	<b>9,696,493</b>	<b>9,008,889</b>
<b>Rrjeti Rrugor</b>	<b>3,163,856,392</b>	<b>3,737,189,183</b>	<b>3,252,494,501</b>
<b>Transporti Publik</b>	<b>271,768,597</b>	<b>322,211,217</b>	<b>189,029,286</b>
<b>Projekte Zhvillimi</b>	<b>33,485,947</b>	<b>38,486,047</b>	<b>23,861,282</b>
<b>Zhvillimi i Turizmit</b>	<b>16,730,000</b>	<b>23,230,000</b>	<b>14,207,246</b>
<b>Menaxhim i Mbetjeve</b>	<b>1,925,564,551</b>	<b>2,195,956,111</b>	<b>1,976,105,600</b>

<i>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</i>	1,475,995,950	1,859,659,690	797,572,735
<i>Programet e Zhvillimit</i>	90,000,000	135,448,849	107,387,327
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	2,970,187,356	3,714,687,021	3,035,289,570
<i>Ndricim Rrugesh</i>	310,000,000	326,000,000	275,997,340
<i>Sport dhe Argetim</i>	294,548,575	319,491,598	272,278,560
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	426,440,470	643,592,205	479,776,504
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollar</i>	2,613,616,342	2,512,489,872	2,037,518,476
<i>Arsimi i mesem i per gjithshem</i>	1,236,698,515	1,589,889,357	1,221,382,664
<i>Arsimi profesional</i>	113,901,789	138,272,774	105,368,215
<i>Kujdesi Social per personat e semure &amp; me aftesi te kufizuar</i>	15,600,000	17,400,000	17,057,150
<i>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</i>	238,130,720	279,782,840	176,072,384
<i>Papunesia, Arsim &amp; Aftesim profesional</i>	25,000,000	27,730,610	13,237,664
<i>Strehim Social</i>	132,078,277	130,272,325	65,296,083
<b>TOTAL</b>	<b>20,404,027,959</b>	<b>23,635,768,506</b>	<b>18,109,529,120</b>

Në tabelën me poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe per bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve te deleguara për kete periudhe vjetore 2020. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministritive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Qendrën Kombëtare të Biznesit
- Ndihmëni Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale
- Bursa te ndryshme ne arsim

Emertimi	Plan 2020	Fakti 2020	%
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	92,860,349	90,869,008	98%
<i>Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile</i>	2,416,959	2,416,959	
<i>Rrjeti Rrugor</i>	204,159,085	198,464,484	97%
<i>Menaxhim I Mbetjeve</i>	700,000,000	700,000,000	100%
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	42,254,038	-	0%
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollar</i>	30,847,637	27,533,209	89%

<i>Arsimi i mesem i pergjithshem</i>	2,230,000	751,359	34%
<i>Arsimi profesional</i>	18,016,736	12,435,464	69%
<i>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</i>	3,174,662,112	3,168,384,780	100%
<b>TOTAL</b>	<b>4,267,446,916</b>	<b>4,200,855,263</b>	<b>98%</b>

Gjate vitit 2020 kemi pasur rishikim të buxhetit; 11 (njembedhjetë) vendime të Këshillit Bashkiak si dhe 11 (njembedhjetë) Urdhër Kryetari për rishpërndarje dhe detajim te fondeve brenda të njëjtit program:

Me VKB 22 date 17.03.2020 Shtesa e fondit të mbartur nga viti 2019

Shtesa e fondit të mbartur nga viti 2019 referuar ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe Udhëzimit Plotësues “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, ku të ardhurat e papërdorura të një viti buxhetor trashëgohen në vitin pasardhës, duke mbajtur në konsideratë që Akt-rakordimet me Degën së Thesarit kryhen pas miratimit të buxhetit nga Këshilli Bashkiak, Vendimin Nr.157, datë 26.12.2019, u miratuan për përdorim në buxhetin e këtij viti duke u reflektuar në VKB nr. 22 datë 17.03.2020

Referuar Akt-rakordimeve përfundimtare fondi i mbartur në total është në vlerën 2,989,465,525 lekë i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura 2,335,423,788 lekë; nga transferta e pakushtëzuar në shumën 654,041,737 lekë. Ndërsa vlera e fondeve të mbartura nga donatorët është në shumën 31,472,894 lekë.

- ✓ Gjatë vitit 2020 në kuadër të COVID-19, shpenzimet në Bashkinë Tiranë arrijnë në shumën 527,198,770 lekë.
- ✓ Gjatë vitit 2020 në kuadër të procesit të rindërtimit pas tërmeteve 2019, shpenzimet në Bashkinë Tiranë arrijnë në shumën 2,154,086,563 lekë.

### 1. Evidentimi i kërkesave për ndryshime në buxhet

- Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, për vitin 2020, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim. Me VKM “Për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar, ii. financimin për rikonstrukcion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat).

Në mënyrë që Bashkia e Tiranës të mund të vijojë me procedurat e prokurimit, duhet detajimi i këtyre fondeve në emërtimin e duhur, në strukturën dhe programin buxhetor sipas buxhetit të Bashkisë Tiranë, reflektuar në Vendime te Keshillit Bashkiak.

- Kryesisht rishperndarja e fondeve janë bërë për investime që kanë fond të kursyer si rrjedhojë e kontratave të lidhura kundrejt kostove dhe planeve buxhetore apo dhe objekte që referuar periudhes deri me 15 nentor ende nuk ka nisur procesi i prokurimit duke i shtyrë në një moment të dytë.
- Për shkak të situatës së krijuar nga rënia e tërmjetit në Shtator të vitit 2019, u njoftuan disa herë nga Dega e Thesarit Tiranë mbi vendime të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi limitimin e përdorimit të cashit për Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke prioritizuar vetëm pagesa për bonus strehimi, emergjencia civile referuar projekt vendimeve të shumta të miratuara nga Këshilli Bashkiak Tiranë referuar situatës së emergjencës. Kjo situatë bëri që shumë pagesa shpenzimesh dhe investimesh që ishin parashikuar të likujdoheshin brenda vitit 2019 nuk u realizuan. Kjo situatë solli problematika duke rritur në mënyrë të konsiderueshme detyrimet e prapambetura nga viti 2019 të cilat nuk mundën të planifikohen në buxhetin e vitit 2020.

Referuar sa më lart, paraqitet e nevojshme përfshirja e këtyre detyrimeve në buxhetin e vitit 2020 për aparatin e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemime në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpérndarje fondesh

- Në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore si pasojë e situatës nga virusi Covid-19, Bashkia Tiranë nëpërmjet Institucioneve të saj mori masa duke alokuar fonde për Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelberimit për përballimin e kësaj situate të krijuar, fond që do përdoret për dezifikimin e stolave, lulishteve etj, pasi kemi një frekuentim me te madh te lulishteve dhe hapesirave te gjelbra gjate kesaj periudhe.  
-Drejtorise së Përgjithshme e Objekteve Publike, për marrjen e masave për dizifikim të qytetit dhe blerje paisjesh dizifektuese, në blerje materiale pastrimi për objektet shkollore, blerje pellet per ngrohje, karburant dhe mirmabajtje te kaldajave, blerje materiale për mbrojtjen personale ndaj COVID si dhe blerje uniforma dhe veshje speciale për punonjësit e DDD. Gjithashtu i janë shtuar fondet për blerjen e paketave ushqimore për shtresat në nevojë duke pakësuar fondin e emergjencave.

U shtuan fonde për pastrimin e qytetit si dhe për mbulimin e shpenzimeve te transportit te bluzave te bardha ne kuadër të situatës.

Përfshirjen në buxhet të blerje termometra statikë elektronikë për matjen e temperaturës në kuadër të masave të marra ndaj Covid si dhe blerje bicikleta për Policinë Bashkiake

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2020 kryesisht në ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim projekte dhe oponanca për objekte të reja ndërtimore etj.
- Duke qenë se Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjikutës ka kërkuar nga Bashkia Tiranë uljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për periudhën 1 prill 2020 –31 dhjetor 2020 për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e pasagjerëve si dhe nga ana e Shoqatës shqiptare të turizmit ATA me anë të shkresave dhe takimeve të vazhdueshme është kërkuar heqja e taksës së ndërtuesës për strukturat akomoduese hoteliere për vitin 2020, me një vendim Këshilli Bashkiak për ndryshim buxheti, për të

ofruar lehtësi për dy sektorët e sipërcituar, duke sjellë kështu një impakt në uljen e taksave dhe tarifave vendore në shumën 55,554,000 lekë

- Me VKB u miratua "Shporta e Bebes", si një projekt që do të zëvëndëson bonusin për fëmijë, bonus i cili paguhet nga Bashkia e Tiranës. Duke qenë se kontrata përfitimin e shportes së bebes u lidh në 16.10.2020, dhe referuar informacionit paraprak dhe VKB u miratua një shtesë në zërin e bonusit për fëmijë, duke marrë parasysh periudhën Shkurt-Shtator (duke qenë se kontrata ende nuk ishte lidhur) nevojitet një shtesë në fondin e bonusit për fëmijë në buxhetin e viti 2020 për të bërë të mundur përballimin e efekteve financiare dhe për periudhën e munguar.
  - ✓ Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, Bashkia Tiranë raporton në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 1 datë 17.01.2019 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019" cdo 3-mujor pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Bashkia Tiranë ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura viti 2020. Shuma e detyrimeve të mbeturës së përfshin 761,791,637 lekë nga e cila vetëm 5 % është përvendosur gjyqesore ndërsa 55 % janë për investime.
  - ✓ Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës

Gjatë vitit 2020, NUK është përdorur Fondi Rezervë dhe ai i Kontigjencës.

## KAPITULLI III

### *Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve*

#### **1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”**

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, kahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 77%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 84%
- Shpenzime të tjera operative 74%
- Shpenzime kapitale 37%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	1,553,946,571	1,310,069,454	84%
Shpenzime te tjera operative	1,611,597,392	1,195,965,058	74%
Shpenzime kapitale	152,424,934	56,725,713	37%
<b>Totali</b>	<b>3,317,968,897</b>	<b>2,562,760,225</b>	<b>77%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Planifikim, Menaxhim & Administrim



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti "Fillo me një ide, fito një praktikë pune në BT" janë planifikuar 5,000,000 lekë për vitin 2020 dhe është realizuar 2,039,988 lekë, ose 41% të planit.
- ✓ Projekti 'Marrje mjetesh rrugore me qera operacionale (leasing) për Bashkinë Tiranë', janë planifikuar 53,452,800 lekë për vitin 2020, dhe është realizuar 36,102,194 ose 68% te planit.
- ✓ Projekti "Subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësave të ujit për kategorinë në nevojë", janë planifikuar 10,000,000 lekë për vitin 2020 dhe është realizuar 4,568,943 lekë, ose 46% të planit.
- ✓ Detyrime gjyqesore, janë planifikuar 456,500,752 lekë për vitin 2020 dhe është realizuar 430,345,209 lekë, ose 94% të planit.
- ✓ Investimet për programin e Planifikim, Menaxhim dhe Administrim për vitin 2020 janë rreth 26 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; softëare, hardëare, mirëmbajtje; të tjera) që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion.

## 2. Programi "Çështje Financiare & Fiskale"


Në këtë program bën pjesë - Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 89%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| • Shpenzimet e Personelit      | 92% |
| • Shpenzime të tjera operative | 74% |
| • Shpenzime kapitale           | 82% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	260,967,000	241,360,665	92%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	66,590,000	49,561,196	74%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,942,000	2,413,300	82%
<b>Totali</b>	<b>330,499,000</b>	<b>293,335,161</b>	<b>89%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin ‘Cështje Financiare & Fiskale per vitin 2020 janë 3 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion.

### **3. Programi ‘Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshem’**

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë

Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm / Shpenzime për interesa

- Shpenzime të tjera operative 0 %

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime te tjera operative	338,767,306		0%

Për vitin 2020, në këtë program duke ju referuar programit COFOG në MFE, janë përfshirë pagesa të interesave për kreditë e marra për banesa sociale, objekte arsimore dhe zhvillimin e rrugëve.

### **4. Programi “Shërbimet e Policisë Vendore**

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83 %. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 87%
- Shpenzime të tjera operative 33%
- Shpenzime kapitale 0%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	457,542,000	396,169,082	87%
Shpenzime te tjera operative	24,440,000	8,138,783	33%
Shpenzime kapitale	6,660,000		0%
<b>Totali</b>	<b>488,642,000</b>	<b>404,307,865</b>	<b>83%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Shërbimet e Policisë Vendore



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2020 janë 2 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion.

## 5. Programi “Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Emergjencën Civile.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 79%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 84%
- Shpenzime të tjera operative 78%
- Shpenzime kapitale 88%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personelli</i>	146,015,200	121,981,214	84%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	1,885,639,117	1,472,978,692	78%
<i>Shpenzime kapitale</i>	152,984,575	134,939,450	88%
<b>Totali</b>	<b>2,184,638,892</b>	<b>1,729,899,356</b>	<b>79%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti “Blerje paketa ushqimore për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë”, janë planifikuar 69,700,000 lekë për vitin 2020 në proces, dhe janë realizuar 69,616,800 lekë gjatë kësaj periudhe.
- ✓ Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2020 përbëhet nga 9 projekte / investime të Emergences Civile dhe 5 projekte / investime të Mbrojtjes nga Zjarri që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Për vitin 2020 shpenzimet kapitale, struktura e Emergjencave Civile zë peshën më të madhe të projekteve, 9-fish të mbrojtjes nga zjarri.


## 6. Programi “Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik”

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 18%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime të tjera operative	78,000,000	13,667,047	18%
<b>Totali</b>	<b>78,000,000</b>	<b>13,667,047</b>	<b>18%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për programin ‘Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik’ shpenzimet korente për vitin 2020 janë 6 projekte, nga te cilet realizuar projekti per Organizaten jo-fitimprurese TID. Buxheti i planifikuar për këtë program është 78 milion lekë për vitin 2020, realizuar 13,667,047 leke ose ne masen 18% te planit.

## 7. Programi “Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi”

Ky program është në mbështetje të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së funksionimit të tregjeve në territorin e Bashkisë Tiranë dhe menaxhohet nga Agjencia e Administrimit të Tregjeve me burim nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 53%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit


91%

- Shpenzime të tjera operative 64%
- Shpenzime kapitale 0%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	33,838,000	30,827,893	91%
Shpenzime të tjera operative	32,000,000	20,491,322	64%
Shpenzime kapitale	31,112,106	-	0%
<b>Totali</b>	<b>96,950,106</b>	<b>51,319,215</b>	<b>53%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi per vitin 2020 përbëhet nga 7 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 31,112,106 lekë për vitin 2020, të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2020.

## 8. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve”

Në këtë program bën pjesë:


- Aparati i Bashkisë
- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 77%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 89%
- Shpenzime të tjera operative 69%
- Shpenzime kapitale 29%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	172,871,000	153,379,244	89%
Shpenzime të tjera operative	190,453,766	131,162,837	69%
Shpenzime kapitale	13,060,000	3,830,928	29%
<b>Totali</b>	<b>376,384,766</b>	<b>288,373,009</b>	<b>77%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti 'Regjistri i Fermerëve të Bashkisë Tiranë', është planifikuar 48,338,966 lekë per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 48,338,960 lekë, ose në masën 100% te planit.
- ✓ Investimet për programin e Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve për vitin 2020 përbëhet nga 8 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 13,060,000 lekë për vitin 2020, të cilat janë realizuar në vlerën 3,830,928 lekë ose në masën 29% të planit.

## 9. Programi “Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit”


Ky program menaxhohet kryesisht nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (Transferta e Pakushtëuar Sektoriale)

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës është në masën 37% gjatë vitit.

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personelli</i>			
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	20,496,028	20,392,907	99%
<i>Shpenzime kapitale</i>	35,329,293		0%
<b>Totali</b>	<b>55,825,321</b>	<b>20,392,907</b>	<b>37%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



## 10. Programi “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave”

Ky program menaxhohet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëuar Sektoriale.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 93%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 93%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %

			%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	<b>9,696,493</b>	<b>9,008,889</b>	<b>93%</b>
<b>Totali</b>	<b>9,696,493</b>	<b>9,008,889</b>	<b>93%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Administrimi i pyjeve  
dhe kullotave



## 11. Programi “Rrjeti Rrugor”

Ky program eshte ne funksion te ndërtimit dhe mirembajtjes se rrugeve ne zonat urbane dhe rurale. Në këtë program bëjnë pjesë Insitucionet e varësisë si më poshtë:


- Aparati i Bashkisë,
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 88 %. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e Personelit	91%
• Shpenzime të tjera operative	91%
• Shpenzime kapitale	86%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	346,760,568	317,024,879	91%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	612,924,317	557,535,761	91%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,981,663,383	2,576,398,345	86%
<b>Totali</b>	<b>3,941,348,268</b>	<b>3,450,958,985</b>	<b>88%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si meposhtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti ‘Menaxhimi dhe mirembajtja e sheshit Skenderbej’, është planifikuar 49,811,422 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 38,836,630 leke, ose në masën 78% të planit.
- ✓ Projekti ‘Shpenzime per transportin publik ne kushtet e emergencies’, është planifikuar 57,195,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 57,195,000 leke, ose në masën 100 %.
- ✓ Investimet për programin e Rrjeti Rrugor per vitin 2020 janë rreth 125 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; te tjera) qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion.

## 12. Programi “Transporti Publik”

Në këtë program bën pjesë Tirana Parking si Institucion varësie


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 9%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| • Shpenzimet e Personelit      | 83% |
| • Shpenzime të tjera operative | 70% |
| • Shpenzime kapitale           | 26% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	110,649,000	92,107,833	83%

<i>Shpenzime te tjera operative</i>	95,310,000	66,521,911	70%
<i>Shpenzime kapitale</i>	116,252,217	30,399,542	26%
<i>Totali</i>	322,211,217	189,029,286	59%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Transportit Publik per vitin 2020 janë rreth 18 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; te tjera) qe menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar per kete program është 116,252,217 leke per vitin 2020, të cilat janë realizuar në vlerën 30,399,542 leke ose në masën 26 % të planit.
- ✓ Investimet per Parkime, rreth 10 projekte, ku jane planifikuar 79,331,487 leke per vitin 2020, ndersa jane realizuar në vlerën 18,577,366 leke, ose në masën 23%.

### 13. Programi “Projekte Zhvillimi”

Në këtë program përfshihen projekte qe zhvillohen nga Aparati i Bashkise


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 62%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 16%
- Shpenzime kapitale 97%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	16,693,017	2,750,705	16%
<i>Shpenzime kapitale</i>	21,793,030	21,110,577	97%
<b>Totali</b>	<b>38,486,047</b>	<b>23,861,282</b>	<b>62%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Projekte Zhvillimi



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti AIRTHINGS, është planifikuar 17,884,388 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 14,549,951.000 leke, ose në masën 81% të planit.
- ✓ Projekti BAS "Benefit as you save", është planifikuar 8,153,460 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 4,311,231.000 leke, ose në masën 53% të planit.
- ✓ Investimet për programin projekte Zhvillimi per vitin 2020 janë 3 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; te tjera) qe menaxhohen nga aparati që mbulon këtë funksion.

#### 14. Programi “Zhvillimi i Turizmit”

Në këtë program përfshihen projekte për zhvillimin e turizmit nga Aparati i Bashkise

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 61%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative ...%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personelli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	23,230,000	14,207,246	61%
<i>Shpenzime kapitale</i>			
<b>Totali</b>	<b>23,230,000</b>	<b>14,207,246</b>	<b>61%</b>

Për vitin 2020 vlen të përmenden Projekte Turizmi, është planifikuar 14,965,397 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 14,207,246 leke, ose në masën 95%, të cilët zënë një peshë specifike 64.4% në këtë funksion

## 15. Programi “Menaxhim i Mbetjeve”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkise


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 92%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 92%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personelli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	2,895,956,111	2,676,105,600	92%
<i>Shpenzime kapitale</i>			
<b>Totali</b>	<b>2,895,956,111</b>	<b>2,676,105,600</b>	<b>92%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në programin Menaxhim i mbetjeve paraqitet si meposhtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Menaxhim i mbetjeve



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Pastrimi i Qytetit, është planifikuar 1,615,956,111 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 1,396,105,600 leke, ose në masën 86 % të planit.
- ✓ Shpenzime për Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike qe eshte edhe ne funksion te zhvillimit dhe mirembajtjes se infrastruktures vendore rjonale, është planifikuar 1,280,000,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në në masën 100% .

## **16. Programi “Strehimi Lokal dhe Urbanistika”**

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit.


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 41%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| • Shpenzimet e Personelit      | 85% |
| • Shpenzime të tjera operative | 6%  |
| • Shpenzime kapitale           | 39% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	155,398,980	132,345,323	85%
Shpenzime te tjera operative	30,113,570	1,707,064	6%
Shpenzime kapitale	3,111,295,481	1,216,093,016	39%
<b>Totali</b>	<b>3,296,808,031</b>	<b>1,350,145,403</b>	<b>41%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në programin Strehimi lokal dhe me poshtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Strehimi lokal dhe urbanistika



Objekti i ketij programi eshte ndertimi i veprave publike ne sherbim te komunitetit. Si edhe rishperndarja e prones publike, duke bere keshtu qe objekti i shpronësimit te jete paresor ne kete program.

- ✓ Inspektoriat i Mbrojtjes se Territorit, per te cilin është planifikuar 159,712,550 leke per vitin 2020, e cila eshte realizuar 134,052,387 leke, ose ne masen 84% te planit.
- ✓ Investimet për programin e Strehimit Lokal dhe Urbanistikes per vitin 2020 janë 3 projekte /shpronësime dhe studime qe menaxhohen nga aparati bashkise që mbulon këtë funksion.

## 17. Programi “Programet e Zhvillimit”


Në këtë program përfshihen projekte qe zhvillohen nga Aparati i Bashkise

Realizimi i shpenzimeve te tjera korente për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 16%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| • Shpenzime të tjera operative | 33% |
| • Shpenzime kapitale           | 16% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	42,000,000	13,938,478	33%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,668,484,042	261,311,857	16%
<b>Totali</b>	<b>1,710,484,042</b>	<b>275,250,335</b>	<b>16%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si meposhtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifikë në këtë funksion:

- ✓ Projekti ‘Fondi i komuniteteve’, është planifikuar 42,000,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 13,938,478 leke, ose në masën 33 % të planit.
- ✓ Investimet për programin e Zhvillimit per vitin 2020 perfshihen fondet e rindertimit si transferte e pakushtezuar me VKM perkatese.

## 18. Programi ‘Sherbime Publike Vendore’

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve të Rekreacionit
- Agjencia e Shërbimeve Funerale


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 75%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

• Shpenzime Personeli	93%
• Shpenzime të tjera operative	94%
• Shpenzime kapitale	67%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personelli	749,212,622	693,319,497	93%
Shpenzime te tjera operative	473,482,578	445,313,672	94%
Shpenzime kapitale	2,843,343,405	1,917,300,064	67%
<b>Totali</b>	<b>4,066,038,605</b>	<b>3,055,933,233</b>	<b>75%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në programin sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si meposhtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Shërbimet Publike Vendore



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifikë në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Sherbimeve Publike Vendore per vitin 2020 janë rreth 130 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; te tjera) qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojne këtë funksion.

## 19. Programi “Ndriçim Rrugësh”

Ky program menaxhohet nga:


- Aparati i Bashkisë dhe
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 85%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 85%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	326,000,000	275,997,340	85%
<i>Shpenzime kapitale</i>			
<b>Totali</b>	<b>326,000,000</b>	<b>275,997,340</b>	<b>85%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objekti i ketij programi eshte mirembajtja dhe ndricimi i rrugeve dhe ambienteve publike ne territorin e Bashkise Tirane.

- ✓ Ndriçimi i qytetit, është planifikuar 276,000,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 275,997,340 leke.

## 20. Programi “Sport dhe Argetim”

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë

- Aparati i Bashkisë
- Agjencia e Rinise
- Klubi Sportiv Tirana,
- Klubi shumësportësh “Partizani” dhe
- Klubi Sportiv “Studenti”.


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 85%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| • Shpenzimet e Personelit      | 84% |
| • Shpenzime të tjera operative | 91% |
| • Shpenzime kapitale           | 70% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	64,564,340	54,409,311	84%
Shpenzime te tjera operative	187,336,010	170,565,132	91%
Shpenzime kapitale	67,591,248	47,304,117	70%
<b>Totali</b>	<b>319,491,598</b>	<b>272,278,560</b>	<b>85%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:

Realizimi i shpenzimeve ne programin Sport dhe argëtim



Ky program eshte ne funksion te krijimit dhe mirembajtjes te hapësirave sportive dhe organizimit te aktiviteteve per rinine.

Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekte Rinore janë planifikuar 20,900,000 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 20,718,500 leke, ose realizuar në masën 99 % të planit.
- ✓ Projekte Sportive janë planifikuar 15,000,000 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 8,950,598 leke, ose realizuar në masën 60 % të planit.
- ✓ Investimet për programin Sport dhe Argetim për vitin 2020 janë rreth 14 projekte / investime qe menaxhohen nga Insitucionet që mbulojne këtë funksion.

## **21. Programi “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”**

Në këtë program bëjnë pjesë Insitucionet e varësisë si më poshtë

- Aparati i Bashkisë
- Aparati i Bashkisë ( Qendra Rinore Ten )
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtepia Studio Kadare"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit te Veprave te Artit Tirane.


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 70%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e Personelit	87%
• Shpenzime të tjera operative	80%
• Shpenzime kapitale	24%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	73,308,000	63,715,289	87%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	475,811,225	382,566,927	80%
<i>Shpenzime kapitale</i>	136,727,018	33,494,288	24%
<b>Totali</b>	<b>685,846,243</b>	<b>479,776,504</b>	<b>70%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si meposhtë:

**Realizimi i shpenzimeve ne programin Trashëgimia kulturore,  
eventet artistike dhe kulturore**



Ky program është në funksion të krijimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së projekteve/ambienteve kulturore dhe artistike.

Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekte Kulturore janë planifikuar 275,948,825 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 236,389,797 leke, ose realizuar në masën 86% të planit.
- ✓ Projekti TOURNEE, janë planifikuar 11,642,400 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 6,016,657 leke, ose realizuar në masën 52% të planit.
- ✓ Shërbimi i Dekorit të Qytetit, janë planifikuar 99,360,000 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 99,072,177 leke.
- ✓ Investimet për programin e Trashëgimia kulturore, Eventet artistike dhe kulturore per vitin 2020 janë rreth 20 projekte / investime qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar per kete program është ..... leke per vitin 2020, të cilat janë realizuar në vlerën 5,664,304 leke ose në masën 6%.

## **22. Programi “Arsimi Baze përfshirë Arsimin Parashkollar”**

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë:

- Aparati i Bashkisë,
- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.


Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 66%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e Personelit	86%
---------------------------	-----

- Shpenzime të tjera operative 71%
- Shpenzime kapitale 66%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	1,278,446,780	1,096,371,215	86%
Shpenzime te tjera operative	554,701,108	395,630,612	71%
Shpenzime kapitale	1,569,605,477	761,995,437	49%
<b>Totali</b>	<b>3,402,753,365</b>	<b>2,253,997,264</b>	<b>66%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollar per vitin 2020 janë rrëth 80 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; te tjera) qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar per kete program është 1,423,352,753 leke per vitin 2020, të cilat janë realizuar në vlerën 761,995,437 leke ose në masën 49%.
- ✓ Projekti ‘Stimuli i nxënësve me dhjeta’ janë planifikuar 70,000,000 lekë për vitin 2020, dhe janë realizuar 69,999,000 leke, ose në masën 100% .

### 23. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë:


- Aparati i Bashkisë,
- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 69%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 89%
- Shpenzime të tjera operative 83%
- Shpenzime kapitale 41%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	576,101,121	511,825,868	89%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	580,249,706	480,084,028	83%
<i>Shpenzime kapitale</i>	667,983,815	271,289,204	41%
<b>Totali</b>	<b>1,824,334,642</b>	<b>1,263,199,100</b>	<b>69%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si meposhtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Arsimit i mesëm i përgjithshëm per vitin 2020 janë rreth 50 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; oponence teknike; të tjera) qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion.
- ✓ Projekti 'Nxenes qe regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesem e te larte ne institucionet arsimore publike' me fonde te kushtezuara janë planifikuar 2,230,000 leke per vitin 2020, dhe janë realizuar 751,359 leke, ose në masën 34%.

## **24. Programi “Arsimi Profesional”**


Në këtë program bën pjesë Drejtoria e Konvikteve si institucion varësie.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 75%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 88%
- Shpenzime të tjera operative 62%
- Shpenzime kapitale 0%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	86,020,100	75,460,956	88%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	68,269,410	42,342,723	62%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,000,000	-	0%
<b>Totali</b>	<b>156,289,510</b>	<b>117,803,679</b>	<b>75%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në programin Arsimi profesional paraqitet si meposhtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti Bursa te perfitura nga nxenesit e Arsimit Profesional janë planifikuar 7,873,380 leke per vitin 2020, dhe janë realizuar 7,873,196 leke, ose në masën 100%.

## **25. Programi “Kujdesi Social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar**

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë,

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 98%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 98%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	17,400,000	17,057,150	98%
<b>Totali</b>	<b>17,400,000</b>	<b>17,057,150</b>	<b>98%</b>

Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti ‘Komisione per pagesa NE+PAK’ janë planifikuar 17,400,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 17,057,150 leke, ose në masën 98% të planit.

## 26. Programi “Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët”

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë


- Aparati i Bashkisë,
- Qendra Sociale Multidisiplinare,
- Qendra Komunitare “Shkozë”,
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”
- Qendra Komunitare “Strehëza” dhe
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhiu”,

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 96%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 79%
- Shpenzime të tjera operative 97%
- Shpenzime kapitale 27%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	108,859,000	86,441,145	79%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	3,342,639,032	3,257,720,219	97%
<i>Shpenzime kapitale</i>	37,905,255	10,299,252	27%
<b>Totali</b>	<b>3,489,403,287</b>	<b>3,354,460,616</b>	<b>96%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti ‘Bonusi per femije’ janë planifikuar 44,000,000 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 34,805,000 leke, ose në masën 79% të planit.
- ✓ Projekti ‘Ndihme financiare për studentët e evakuar në RZU Nr.3’ janë planifikuar 11,350,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 5,982,000 leke, ose në masën 53 % të planit.
- ✓ Ndihma Ekonomike / Paaftesia / Sherb perkujdes shoqeror, Kuota ushqimore per viktimat e trafikimit, femijeve me autizem e te moshuarve, janë planifikuar 4,940,965 leke per 2020, dhe është realizuar në vlerën 1,760,700 leke, ose në masën 36%.
- ✓ Projekti ‘Bonusi i qerase’ janë planifikuar 592,462,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 591,905,000 leke, ose në masën 100% .
- ✓ Projekti ‘Mbrojtja Sociale per kategorine e familjeve ne nevoje te perjashtuara nga skema e NE’ janë planifikuar 8,689,200 leke per vitin 2020 dhe është realizuar në vlerën 8,633,132 leke, ose në masën 99% të planit.
- ✓ Projekti ‘Shporta e Bebes’, janë planifikuar 24,000,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 2,114,600 leke, ose në masën 9% .
- ✓ Investimet për programin e Kujdesi social për familjet dhe fëmijët per vitin 2020 janë 10 projekte / investime qe menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion.

## 27. Programi “Papunësia, Arsim dhe Aftësim Profesional”

Në këtë program përfshihen projekte qe zhvillohen nga Aparati i Bashkise

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 48%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 48%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	27,730,610	13,237,664	48%
<b>Totali</b>	<b>27,730,610</b>	<b>13,237,664</b>	<b>48%</b>

Për vitin 2020 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti 'Fuqizimi i grave dhe nxitja e supermarrjes', është planifikuar 10,000,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 9,500,000 leke, ose në masën 95% të planit.
- ✓ Projekti "Programi i Nxitjes së Punësimit të Biznesit Rinor", është planifikuar 3,500,000 leke per vitin 2020, dhe është realizuar ne vleren 3,499,800 ose në masën 100% të planit.
- ✓ Projekti "Të rinj dhe të reja drejt një profesioni", është planifikuar 238,610 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 237,864 leke, ose në masën 100% të planit .

## 28. Programi “Strehimi Social”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 50%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 41%
- Shpenzime kapitale 97%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2020	Fakti 2020	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personelli</i>			
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	109,294,468	44,884,515	41%
<i>Shpenzime kapitale</i>	20,977,857	20,411,568	97%
<b>Totali</b>	<b>130,272,325</b>	<b>65,296,083</b>	<b>50%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objekti i ketij programi eshte ndertimi i veprave publike ne sherbim te komunitetit. Si edhe rishperndarja e prones publike, duke bere keshtu qe objekti i shproncesimit te jete paresor ne kete program.

- ✓ Projekti 'Bonus Strehimi', është planifikuar 109,294,468 leke per vitin 2020, dhe është realizuar në vlerën 44,884,515 leke, ose në masën 41% të planit.
- ✓ Investimet për programin e Strehimit Social per vitin 2020 janë 4 projekte /shpronsimë qe menaxhohen nga aparati bashkise që mbulon këtë funksion. Buxheti i planifikuar 32,078,277 leke per vitin 2020, dhe jane realizuar 20,411,568 ose në masën 97 %.

## KAPITULLI IV

### **Ecuria e buxhetit te Bashkise Tirane per vitet 2017- 2020**


Edhe pse situata ekonomike nga pandemja e “COVID-19”, në vijim të pasojave të tërmeteve gjate vitit 2019, ka ndryshuar trajektoren e realizimit të shpenzimeve duke afektuar si shpenzimet operative dhe ato kapitale., përsëri nga ana e Bashkisë Tiranë është tentuar që të ecet duke tjetkaluar vështirësitë.

Konkretnisht pavarësisht situatës fakti per vitin 2020 vijojme të jemi me rritje krahasuar me vitet e mëpardhme.

Më poshtë gjeni dhe një historik të realizimit të buxhetit me të gjitha burimet e financimit dhe në bazë të klasifikimit ekonomik të Bashkisë Tiranë ndër vite.

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 2017	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020
<i>Shpenzime personelli</i>	4,368,127,003	4,782,498,543	5,096,091,890	5,376,808,868
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	5,843,494,491	8,275,540,916	9,330,863,601	11,779,539,238
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,686,712,436	6,753,918,922	7,349,200,635	7,365,316,658
<b>Totali</b>	<b>14,898,333,930</b>	<b>19,811,958,381</b>	<b>21,776,156,126</b>	<b>24,521,664,764</b>

Si dhe paraqitjen grafike te tyre:



## Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2017 - 2020

Shpenzimet sipas burimeve te financimit	Fakti 2017	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020
<i>Te ardhura BT</i>	8,202,769,532	11,977,156,947	14,359,153,299	14,764,411,358
<i>Transferta e Pakushtezuar*</i>	2,394,607,717	1,983,394,552	2,819,024,010	3,345,123,522
<i>Transferta e Pakushtezuar Sektoriale</i>	956,790,287	1,049,874,650	1,154,603,407	
<i>Transferta e Pakushtezuar Rindertimi</i>				2,154,086,563
<i>Transferta e Kushtezuar</i>	3,318,792,736	4,774,093,186	3,403,107,588	4,200,900,263
<b>Totali</b>	<b>14,872,960,272</b>	<b>19,784,519,335</b>	<b>21,735,888,304</b>	<b>24,464,521,706</b>

\*gjate vitit 2020 transferta e pakushtezuar sektoriale e perfshire te transferta e pakushtezuar sipas njofitimit nga MFE mbi fondet e miratuar per transferten e pakushtezaur 2020-2022.

